UDHËZIM
Nr. 35, datë 7.5.2013

PËR PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE PËR QËLLIME TË FUSHATËS ZGJEDHORE

Mbështetur në shkronjën "c" pika 1 e nenit 30 dhe shkronjën "f" pika 1 e nenit 31 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar, ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008, i përditësuar me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 32, datë 21.6.2010, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

UDHËZON:

Neni 1
Qëllimi

1. Ky udhëzim ka për qëllim përcaktimin e rregullave për përpunimin e të dhënave personale nga kandidatët gjatë zhvillimit të fushatës zgjedhore.
2. Ky udhëzim nuk zbatohet për fletëpalosjet, posterat, materialet informuese dhe materiale të tjera të ngjashme, të cilat nuk përmbajnë të dhëna personale të zgjedhësve.

Neni 2
Përkufizime

Për qëllime të këtij udhëzimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
1. "Kontrollues" është çdo kandidat i regjistruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
2. "Përpunues" është ajo kompani (çdo furnizues shërbimi, operatorët e kompanive celulare etj.), e cila hyn në një marrëdhënie kontraktore me kontrolluesin me qëllim përpunimin e të dhënave personale të zgjedhësve për llogari të kontrolluesit.
3. "Subjekt i të dhënave" është çdo zgjedhës që i jep të dhëna kandidatit për llogari të fushatës së tij zgjedhore.
4. "Kontrata e përpunimit (*outsourcing*)" është akti në bazë të të cilit kontrolluesi i kërkon përpunuesit të kryejë për llogari të tij përpunimin e të dhënave personale ose një pjesë të tyre.
5. "Pëlqimi i informuar" është shfaqja e qartë e vullnetit të zgjedhësve, që shpreh miratimin e tij për përpunimin e të dhënave personale, i cili plotëson kriteret e mëposhtme:
a) është dhënë me shkrim;
b) mban datën dhe nënshkrimin;
c) është dhënë lirisht pas marrjes së informacionit të detajuar në lidhje me natyrën, rëndësinë, efektet etj.;
ç) është i dokumentuar.

Neni 3
Mbledhja e të dhënave personale të zgjedhësve

1. Kandidati, i cili do të përpunojë të dhëna personale të zgjedhësve për qëllime të fushatës zgjedhore, detyrohet t'i mbledhë të dhënat personale drejtpërdrejt nga zgjedhësit, duke siguruar që këta të fundit janë informuar për qëllimin e mbledhjes së të dhënave dhe për mënyrën e përdorimit të tyre.
2. Kandidati nuk mbledh të dhëna personale për fushatë zgjedhore me mjete mashtruese ose duke keqpërdorur qëllimin e mbledhjes. Kandidati ndalohet të përdorë baza të dhënash të grumbulluara për qëllime të tjera, për qëllimin e fushatës zgjedhore.

3. Kur kandidati përdor të dhënat personale të mbledhur nga lista e zgjedhësve në Regjistrin Kombëtar Elektronik të Gjendjes Civile, ai i përdor këto të dhëna vetëm për qëllime që lidhen me zgjedhjet, të përcaktuar nga legjislacioni përkatës.

Neni 4
Dispozita për palët e treta

1. Kandidati mund të japë një kopje të listës zgjedhore për përpunues për qëllime të përpunimit të të dhënave për fushatë zgjedhore. Në këtë rast, duhet të lidhet një kontratë ndërmjet tyre në përputhje dhe me udhëzimin nr. 19, datë 3.8.2012 "Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes Kontrolluesit dhe Përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi" të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

2. Kandidati i garanton përpunuesit se të dhënat janë mbledhur dhe se përdorimi i tyre në mënyrën e udhëzuar nga kandidati është në përputhje me këtë udhëzim dhe me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Marrja e pëlqimit sipas nenit 5, paragrafi 2 të këtij udhëzimi mbetet përgjegjësi e kandidatit, si kontrollues i të dhënave personale të grumbulluara dhe përpunuesi nuk ka detyrim të kontrollojë përmbushjen e këtij detyrimi nga kandidati.

3. Pala e tretë nuk mund të përdorë kopjen e listës zgjedhore për qëllime të tjera nga ato të përcaktuara nga kandidati dhe ky i fundit sigurohet që çdo kopje që ai jep, i kthehen sërish dhe/ose shkatërron në mënyrë të sigurt.

Neni 5
Njoftimi

1. Kandidati është i detyruar të njoftojë Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale paraprakisht, në qoftë se ai ose një palë e tretë në emër të tij, do të përpunojë të dhëna personale për qëllime të fushatës zgjedhore në mënyrë manuale, si dhe duke përdorur pajisje elektronike, të tilla si: kompjuter, e-mail, faks, SMS.

2. Kandidati fitues do të vazhdojë të jetë i regjistruar në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese të komisionerit, pas njoftimit të bërë sipas pikës 1 të këtij neni, për aq kohë sa ai qëndron në detyrë.

3. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve detyrohet të paraqesë pranë Autoritetit të Komisionerit listën e kandidatëve fitues dhe humbës të zgjedhjeve elektorale. Autoriteti i Komisionerit, për kandidatin, i cili në bazë të listës së lartpërmendur rezulton jofitues në zgjedhjet elektorale, e çregjistron nga regjistri elektronik i subjekteve kontrolluese të Komisionerit.

Neni 6
Parimet e mbrojtjes së të dhënave personale

1. Kandidati zbaton parimet e mbrojtjes së të dhënave personale për përpunimin e të gjitha të dhënave personale që mbledh, të tilla si: emri, atësia, mbiemri, datëlindja, kodi i banesës, shtetësia dhe numri personal i identifikimit, numri i telefonit etj. Nëse kandidati përpunon detajet e pikëpamjeve politike, mendimeve apo ndonjë tregues të synimeve të votimit, ky informacion nuk është vetëm e dhënë personale, por është e dhënë sensitive. Në këtë rast merren masa mbrojtëse shtesë për të mbrojtur këtë informacion dhe të dhënat personale sensitive shkatërrohen në mënyrë të sigurt në fund të fushatës në përputhje me udhëzimin nr. 21, datë 24.9.2012 "Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga kontrolluesit e mëdhenj" dhe udhëzimin nr. 22, datë 24.9.2012 "Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga kontrolluesit e vegjël" të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

2. Kandidati merr paraprakisht pëlqimin e dhënë me shkrim nga zgjedhësi në rast se përpunon të dhëna sensitive, si dhe në rast se i përdor të dhënat personale të mbledhura drejtpërdrejt nga zgjedhësit për qëllime të tregtimit të drejtpërdrejtë.

3. Kandidati detyrohet që për komunikimet me SMS për tregtim të drejtpërdrejtë, të lidhë kontratën siç parashikohet në nenin 4 të këtij udhëzimi me një furnizues shërbimi që ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me të gjithë operatorët celularë përkatës për transmetimin e këtyre komunikimeve te pajtimtarët e tyre respektivë.

4. Zgjedhësit kanë të drejtë në çdo kohë të kërkojnë nga kandidati ndalimin e përpunimit të të dhënave sensitive dhe tregtimit të drejtpërdrejtë. Për këtë qëllim, kandidati do të vendosë në komunikim një numër

telefoni pa pagesë, në të cilin zgjedhësit mund të kërkojnë në mënyrë të thjeshtë ndalimin e tregtimit të drejtpërdrejtë.

Neni 7
Të fundit

1. Janë përgjegjës për zbatimin e këtij udhëzimi të gjithë kandidatët e regjistruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për të cilët do të votohet në zgjedhjet lokale.

2. Moszbatimi i kërkesave të këtij udhëzimi, përbën shkelje të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe dënohet sipas nenit 39 të tij.

3. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERE
Flora Çabej (Pogaçe)